LIGJ
Nr. 103/2021

PËR EUROBONDIN QË DO TË EMETOHET NGA MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË, MIRATIMIN E PËRJASHTIMEVE NGA TATIMET E TAKSAT DHE TË PARASHIKIMEVE PËR HEQJEN DORË NGA IMUNITETI NË MARRËVESHJET QË DO TË LIDHEN NGA MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË

Në mbështetje të neneve 78, 83, pikat 1 e 2, dhe 84, pika 4, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në marrëveshjet që do të lidhen nga ministri i Financave dhe Ekonomisë për emetimin e instrumentit "Eurobond", në përputhje me ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006, "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe thelbësisht sipas kushteve të përcaktuara në tekstin e tyre që i bashkëlidhen këtij ligji, lejohen parashikimet për heqjen dorë nga imuniteti.

Neni 2

Mbajtësit e titujve të eurobondit dhe menaxherët bashkëdrejtues, sipas përcaktimeve në marrëveshjet bashkëlidhur, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat, nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe nga çdo tatim apo taksë tjetër në Republikën e Shqipërisë për të gjitha transaksionet dhe veprimtaritë që lidhen me emetimin, mbajtjen, ruajtjen e tregtimin e eurobondeve.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Miratuar më datë 28.10.2021.

Shpallur me dekretin nr. 13303, datë 29.10.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.